



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 99, datë 31.08.2021

PËR

SHFUQIZIMIN E VKB-SË NR.23, DATË 25.02.2021 “PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRISHJES SË DETYRUAR TË 1 (NJË) OBJEKTI BANIMI, PRONË PRIVATE (PALLAT), NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, DURRËS, NË ZBATIM TË EKSPERTIZËS TË THELLUAR HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.23, datë 25.02.2021 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), ndodhur në Njësine Administrative nr.4, Durrës, Ekspertizës të thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë nr.446/2 prot., protokolluar me tonën nr.2274/20 prot., datë 09.07.2021, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Inspektoriat Vendor i Mbrojtjes së Territorit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Shfuqizimin e VKB- së nr.23, datë 25.02.2021 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), ndodhur në Njësine Administrative nr. 4, Durrës, në zbatim të ekspertizës të thelluar hartuar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë”.

2. Me qëllim njoftimin e banorëve dhe palëve të interesuara, vendimi publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës si dhe afishohet në këndin e njoftimeve pranë Njesisë Administrative nr.4.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Zëvendëskryetari i Bashkisë, Drejtorja e Shërbimeve, Drejtorja e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, si dhe Drejtorja e Kabinetit.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 31.08.2021



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES

Nr. 671/2 prot.

Durrës, më 07.09.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.99 datë 31.08.2021 “Për shfuqizimin e VKB-së nr.23, datë 25.02.2021 “Për vijimin e procedurave të prishjes së detyruar të 1 (një) objekti banimi, pronë private (pallat), ndodhur në njësinë administrative nr. 4, durrës, në zbatim të ekspertizës të thelluar hartuar nga instituti i ndërtimit, Tiranë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

